



ГРАД СКОПЈЕ - QYTETI I SHKUPIT

Бр. Nr. 08 - 1394

09. 02. 2026 20

СКОПЈЕ - SHKUP

3



Në bazë të Nenit 4 të Rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurën për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e programeve, projekteve, aktiviteteve programore dhe manifestimeve në fushën e sportit me interes për Qytetin e Shkupit nr. 08 – 757/1 datë 26.01.2026, dhe në lidhje me Programin për aktivitetet në fushën e sportit dhe të rinjve në Qytetin e Shkupit për vitin 2026 („Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit“ nr. 14/25), Qyteti i Shkupit shpall

THIRRJE PUBLIKE

për ndarjen e mjeteve financiare për organizimin dhe realizimin e manifestimit „Përzgjedhja e sportistëve, sportistëve, trajnerit dhe ekipit më të mirë të Qytetit të Shkupit për vitin 2025“

1. Lënda e Thirrjes publike

1.1. Lëndë e thirrjes publike është ndarja e mjeteve financiare për organizimin dhe realizimin e manifestimit "Përzgjedhja e sportistëve, sportistëve, trajnerit dhe ekipit më të mirë të Qytetit të Shkupit për vitin 2025".

1.2. Mjetet financiare për realizimin e manifestimit „Përzgjedhja e sportistëve, sportistëve, trajnerit dhe ekipit më të mirë të Qytetit të Shkupit për vitin 2025“ janë siguruar nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2026.

1.3. Ndarja e mjeteve financiare për organizimin dhe realizimin e manifestimit "Përzgjedhja e sportistëve, sportistëve, trajnerit dhe ekipit më të mirë të Qytetit të Shkupit për vitin 2025" përcaktohet me kriteret të përgjithshme dhe me pikë, të specifikuara në Rregulloren për mënyrën, kriteret dhe procedurën e ndarjes së mjeteve financiare për zbatimin e programeve, projekteve, aktiviteteve programore dhe manifestimeve në fushën e sportit me interes për Qytetin e Shkupit nr. 08-757/1 datë 26.01.2026, që janë pjesë përbërëse e kësaj Thirrjeje publike.

2. E drejta për pjesëmarrje në Thirrjen publike

Të drejtë për pjesëmarrje në Thirrjen Publike kanë subjektet sportive: klubet sportive, shoqatat sportive, institucionet sportive (në tekstin e mëtejshëm: personat juridikë), të regjistruara në Regjistrin Qendror me seli në Shkup, të cilat plotësojnë kriteret e Rregullores dhe kanë depozituar dokumentacionin e nevojshëm.

3. Dokumentacioni i nevojshëm të cilin duhet ta depozitojë aplikanti

3.1. Për pjesëmarrje në Thirrjen publike, aplikanti në mënyrë të detyrueshme duhet të depozitojë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Aplikim i plotësuar (aplikimi do të shpallet në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk);
- Programi dhe plani financiar për organizimin dhe realizimin e manifestimit „Përzgjedhja e sportistëve, sportistëve, trajnerit dhe ekipit më të mirë të Qytetit të Shkupit për vitin 2025“;
- Aktvendim për kryerjen e veprimtarisë sport (për klubet sportive), të lëshuar nga Ministria e Sportit (Agjencia për të Rinj dhe Sport);
- Kopje e Aktvendimit për regjistrim në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

- Kopje e gjendjes aktuale të subjektit jo më e vjetër se 6 muaj, e lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Numri i telefonit të kontaktit, adresa dhe adresa e-mail;
- Vërtetim nga banka për llogari transaksioni aktive të aplikantit;
- Listë referencash për manifestime të organizuara dhe të realizuara të këtij lloji ose të ngjashme, e mbështetur me prova nga federatat përkatëse kombëtare sportive ose institucione të tjera sportive.
- Aplikimet e depozituara duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të pikëzimit që janë pjesë përbërëse e Rregullores, e cila do të shpallet në ueb-faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit (www.skopje.gov.mk).
- Në procedurën për ndarjen e mjeteve financiare nga Programi për aktivitetet në fushën e sportit dhe të rinjve në qytetin e Shkupit për vitin 2026, do të pranohet aplikanti i cili, në përputhje me kriteret dhe listat e pikëve të përcaktuara me Rregulloren, do të fitojë më shumë pikë.

4. Mënyra e zbatimit të Thirrjes publike

4.1. Për të përcaktuar plotësimin e kushteve dhe kriterëve për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e manifestimit „Përzgjedhja e sportistëve, sportistëve, trajnerit dhe ekipit më të mirë të Qytetit të Shkupit për vitin 2025“, kryetari i Qytetit të Shkupit formon Komision për zbatimin e procedurës për ndarjen e mjeteve financiare për programe, projekte, aktivitete programore dhe manifestime në fushën e sportit me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2026 (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).;

4.2 Aplikimet e depozituara me vonesë, të paplota, të plotësuara me dorë dhe që nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret, Komisioni do t'i refuzojë me Konkluzion dhe të njëjtat nuk do të shqyrtohen, gjë për të cilën njofton aplikantët aplikimet e të cilëve janë refuzuar“;

4.3. Për aplikimet e plota, të depozituara në kohë dhe që plotësojnë kushtet dhe kriteret, Komisioni depoziton propozim pranë kryetarit të Qytetit të Shkupit për përzgjedhjen e aplikantit për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e manifestimit;

4.4. Kryetari i Qytetit të Shkupit, me propozim të Komisionit, miraton Aktvendim për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e manifestimit „Përzgjedhja e sportistëve, sportistëve, trajnerit dhe ekipit më të mirë të Qytetit të Shkupit për vitin 2025“;

5. Afati dhe mënyra e depozitimit të aplikimeve

5.1. Thirrja publike shpallet në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit. (www.skopje.gov.mk).

5.2. Thirrja publike do të zgjasë 5 ditë, duke filluar nga data e shpalljes.

5.3. Aplikantët dokumentacionin e nevojshëm duhet ta depozitojnë në zarf të mbyllur nëpërmjet Arkivit të Qytetit të Shkupit, çdo ditë pune ose në adresën bul. “Ilinden” nr.82 - 1000 Shkup me shënimin: “Drejtuar Komisionit për zbatimin e procedurës për ndarjen e mjeteve financiare për programe, projekte, aktivitete programore dhe manifestime në fushën e sportit me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2026”.

5.4. Zarfi nuk duhet të përmbajë asnjë shenjë që mund të identifikojë aplikantin.

5.5. Aplikimi me dokumentacionin e nevojshëm depozitohet në një ekzemplar origjinal, i plotësuar në mënyrë elektronike, i nënshkruar dhe i vërtetuar/vulosur nga personi përgjegjës i aplikantit.

Për informacione shtesë:

Informacione shtesë mund të merren në Sektorin për veprimtari publike – Seksioni për sport dhe të rinj, në telefonat: 3297-238 dhe 3297-320.